PZAP
IPŽP

**Republika e Kosovës – Republika Kosova**
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 128/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues Hasan Shala dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Konstatohen të tërhequra ankesat** me numër: Anr.123/2014 dhe Anr.126/2014 të datës 04.06.2014, të parashtruara në PZAP nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

**Arsyetim**

PZAP, me datë 04.06.2014, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.123/2014 dhe Anr.126/2014 të datës 04.06.2014, të parashtruara në PZAP kundër Aleancës Kosova e Re (AKR) dhe Nismës për Kosovën të cilat kërkohet që të tërhiqen ankesat e lartpërmendura nga shqyrtimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave të sipërshënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos te shqyrtohen ankesat në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP - i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**
Anr.123/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
PZAP IPŽP
Prishtinë / Priština
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke